



I Krishterë



Shenjtërimi



Misionare

KISHA E NAZARENASIT NDËRKOMBETARE
6401 the Paseo
Kansas City, MO 64131

NJË BESIM I GJALLË: ÇFARË NAZARENASIT BESOJNË

Çdo organizate që jeton në kohë është bazuar në një kombinim të qëllimit, besimit dhe vlerave. Kështu ngjet edhe me Kishën e Nazarenasit. Ajo u themelua për të transformuar botën duke ndarë shenjtërinë për të cilën flasin Shkrimet. Ajo është njëkohësisht edhe një kishë e Urdhërimit të Madh edhe një kishë shenjtërie. Misioni ynë është të bëjmë dishepuj nga të gjithë kombet që të jenë të ngjashëm me Zotin tonë Jezus.

Jeta e tashme dhe e ardhme e Kishës së Nazarenasit është e përcaktuar nga pjesmarrja në misionin e Perëndisë. Prandaj ajo është një shprehje e Kishës së Jezus Krishtit dhe të një organizate e dalluar , jo vetëm nga çfarë ajo beson por edhe nga mënyra sesi ajo kontribuon në mënyrë unike në Mbretërinë e Perëndisë.

Tani që Kisha e Nazarenasit po ecën në mijëvjeçarin e ri është me vend të identifikojmë ato veçori që ne me gjëzim përqafojmë dhe celebrojmë. Thesaret tona më të çmuara – misioni ynë, thirrja, besimi, dhe vlerat më të larta – ne me kënaqësi ia ofrojmë si një dhuratë brezave që po vijnë

Ne lutemi që vlerat tona esenciale do të vazhdojnë të shërbejnë si një dritë udhërrëfyese për ata që duhet të ecin në rrugën e tyre përmes dritës dhe errësirës së dekadave që po vijnë përpara.

Vlerat esenciale

1. Ne jemi të Krishterë

Si anëtarë të Kishës Universale ne bashkohemi me të gjithë besimtarët e vërtetë në shpalljen e Jezus Krishtit si Zot dhe në përqafimin e shpalljeve të kredos historike Trinitariane të besimit të Krishtere. Ne vlerësojmë trashgiminë e shenjtërise tonë Wesleyane dhe, besojmë se, ajo është një mënyrë kuptimi i besimit besnik ndaj Shkrimeve, arsyes, traditës dhe përvojës.

2. Ne jemi njerëz të shenjtërisë

Perëndia, i cili është i shenjtë, na thërret ne në një jetë shenjtërie. Ne besojmë se Shpirti i Shenjtë kërkon të kryejë në ne një punë të dytë të hirit, të shënuar me terma të ndryshme, duke përfshirë këtu termat si, "shenjtërim i plotë" dhe "pagëzim me Shpirtin e Shenjtë" – duke na pastruar nga i gjithë mëkatë ; duke na ripërtërirë në imazhin e Perëndisë; duke na dhënë fuqi të duam Perëndinë me gjithë zemrën, mendjen, shpirtin dhe forcën tonë dhe të afërmít tanë si veten tonë; duke prodhuar në ne karakterin e Krishtit. Shenjtëria në jetën e besimtarëve kuptohet më qartë si ngjashmëri me Krishtin.

3. Ne jemi njerëz me mision

Ne jemi "njerëz të dërguar," duke iu përgjigjur thirrjes së Krishtit dhe të fuqizuar nga Shpirti i Shenjtë për të shkuar në të gjithë botën, duke dëshmuar se Jezus Krishti është Zot dhe duke marrë pjesë së bashku me Perëndinë në ndërtimin e Kishës dhe në zgjerimin e Mbretërisë së Tij (2 Korintasve 6:1). Misioni ynë (a) fillon në adhurim, (b) i shërben botës në ungjillëzim dhe në dhëmbshuri, (c) inkurajon besimtarët drejt pjekurisë së Krishtere përmes dishepullizimit dhe, (d) përgatit burrat dhe gratë për shërbimin e Krishterë përmes arsimit të lartë Krishter.

Ese

1. Ne jemi njerëz të Krishterë

Ne bashkohemi me të gjith besimtarët në shpalljen e Jezus Krishtit si Zot. Ne besojmë që në dashurinë hynore Perëndia u ofron të gjithë njerëzve faljen e mëkateve dhe marrëdhënietë rivendosura. Duke qenë të pajtuar me Perëndinë, ne gjithashtu besojmë se duhet të jemi të pajtuar me njeri tjetrit, duke dashur njeri tjetrit ashtu siç jemi dashur nga Perëndia, duke falur njeri tjetrit ashtu siç jemi falur nga Perëndia. Ne besojmë që e gjithëjeta jonë së bashku duhet të reflektojë karakterin e Krishtit. Ne bashkohemi me të Krishterët kudo në afirmimin e kredove Trinitarie historike dhe të çështjeve të besimit të Krishterë dhe vlerësojmë thellësisht trashëgiminë tonë në traditën e Shenjtërisë Wesleyane. Ne shikojmë tek Shkrimet burimin primar të të vërtetës shpirtërore të konfirmuar nga arsyja, tradita, dhe përvoja.

Me të gjithë njerëzit e Perëndisë ne shpallim dhe lavdërojム Jezus Krishtin Zot.

Jezus Krishti është Zoti i Kishës e cila, ashtu si na tregon Kredoja Apostolike, është një, e shenjtë, botërore dhe apostolike. Në Jezus Krishtin dhe përmes Shpirtit të Shenjtë, Perëndia Ati u ofron të gjithë botës faljen e mëkateve dhe pajtim. Ata që i përgjigjen ofertës së Perëndisë me besim bëhen bij të Perëndisë. Duke qenë të falur dhe të pajtuar në Jezus Krishtin, ne falim dhe jemi të pajtuar me njeri tjetrit. Në këtë mënyrë ne jemi Kisha dhe Trupi i Krishtit dhe zbulojmë unitetin e këtij Trupi. Si një Trup i Krishtit ne kemi "një Zot, një besim, një pagëzim". Ne pohojmë unitetin e Kishës së Krishtit dhe përpinqemi me të gjitha gjërat ta ruajmë atë (Efesianëve 4:5,3).

Jezus Krishti është Zoti i shenjtë. Për këtë arsy Kisha e Krishtit nuk është vetëm një, por dhe është e

shenjtë. Ajo duhet të jetë e shenjtë në të gjitha pjesët e saj ashtu edhe në total, e shenjtë në anëtarët e saj ashtu si edhe në Kreun e saj. Kisha është e shenjtë dhe e thirrur të jetë e shenjtë, të dyja njëkohësisht. Është e shenjtë sepse është Trupi i Krishtit i cili u bë për ne drejtësi dhe shenjtëri. Është thirrur të bëhet e shenjtë nga Perëndia, i cili na zgjodhi përpëra themelimit të botës, që të jemi të shenjtë dhe të panjollë. Si një Trup i Krishtit jeta jonë së bashku si Kishë duhet të trupëzojë karakterin e shenjtë të Krishtit, i cili e zbrazi veten e vet dhe mori formën e një shërbëtori. Ne pohojmë shenjtërinë e Kishës së Krishtit, si një dhuratë por edhe si një thirrje.

Jezus Krishti është Zot i Kishës. Për këtë arsyje Kisha nuk është vetëm një, e shenjtë, por edhe universale duke përfshirë të gjithë ata që pohojnë çështjet esenciale të besimit të Krishterë. Ne afirmojmë besimin apostolik që është mbajtur nga të gjithë Krishterët, kudo në të gjithë kohërat. Ne përqafojmë konceptin e John Wesleyit të shpirtit universal, me anë të cilit ne kemi miqësi me të gjithë ata që pohojnë qendrën vitale të Shkrimeve, dhe ne jemi tolerantë ndaj atyre që nuk janë dakort me ne në çështje jo të domosdoshme për shpëtim.

Jezus Krishti është Zot i Shkrimeve. Për këtë arsyje Kisha nuk është vetëm një, e shenjtë, dhe universale, por edhe gjithashtu apostolike. Ajo është ndërtuar mbi themelin e apostujve dhe e profetëve dhe vazhdimisht ia përkushton veten e vet mësimit të apostujve. Kisha veçanërisht shikon mbi Shkrime, të cilat janë e vetmja normë e besimit dhe e jetës së Kishës. Të qenët Zot i Jezus Krishtit mbi Shkrimet do të thotë që ne duhet t'i kuptojmë Shkrimet përmes dëshmisë së Shpirtit të Shenjtë meqë ato dëshmojnë për Jezusin. Për të konfirmuar dhe korriguar kuptimin tonë mbi Shkrimet ne nderojmë dhe i kushtojmë vëmendje kredove të vjetra dhe zérave të tjerë të tradës Krishtere që besnikërisht shpjegojnë Shkrimet. Ne gjithashtu lejojmë të kuptuarit tonë të Shkrimeve të udhëhiqet nga zëri i Shpirtit të

Shenjtë që na llet ne në pendim, besim, dhe në siguri. Së fundi ne testojmë të kuptuarit tonë të Shkrimeve duke kërkuar arsyeshmérinë dhe koherencën e dëshmisë së tyre për Jezus Krishtin.

Ne jemi thirrur veçanërisht për të dëshmuar shenjtërinë e Kishës së Krishtit ashtu siç është përqafuar në traditën e Shenjtërisë Wesleyane. Ne afirmojmë parimet e shpëtimit vetëm me anë të hirit përmes besimit në Jezus Krishtin, Shpëtimtarin tonë. Kështu, ne vazhdojmë të pohojmë se Kisha e Krishtit është një, universale, dhe apostolike. Por thirja jonë e veçantë është të mbajmë përpara syve të botës dhe të Kishës shenjtërinë si qendër dhe të inkurajojmë njerëzit e Perëndisë të jetojnë në plotësinë e dashurisë së shenjtë të Atit. Për këtë arsy ne afirmojmë të kuptuarit e shenjtërisë Wesleyane mbi besimin e Krishterë dhe kërkojmë t'i qëndrojmirë besnik mësimeve themelore të tij: hiri paraprirës i Perëndisë dhe mjetet e hirit, pendimi, besimi, rilindja, përligja, siguria, komuniteti i Krishterë dhe disiplina e tij, si dhe përsosmëria e dashurisë.

2. Ne jemi njerëz të shenjtërisë

Ne jemi tē thirrur nga Shkrimet dhe tē tērhequr nga hiri tē adhurojmë Perëndinë dhe ta duam Atë me gjithë zemrën, shpirtin, mendjen dhe forcën tonë, dhe tē afërmit tanë si veten tonë. Për këtë qëllim ne i përkushtojmë veten Perëndisë plotësisht dhe tērësisht, duke besuar se ne mund tē "shenjtërohemë plotësisht", si një punë e dytë e hirit pas asaj tē shpëtimit. Ne besojmë se Shpirti i Shenjtë na bind, na pastron, na mbush dhe na fuqizon ne në mënyrë që hiri i Perëndisë tē na transformojë nga dita në ditë në njerëz tē dashurisë dhe tē disiplinës shpirt, tē pastërtisë morale dhe etike, dhe tē dhëmbshurisë e drejtësisë. Është puna e Shpirtit tē Shenjtë që rivendos imazhin e Perëndisë në ne dhe prodhon në ne karakterin e Krishtit. Shenjtëria në jetën e besimtarëve kuptohet më qartë si ngashmëri me Krishtin.

Ne besojmë në Perëndinë Atë, Krijuesin, i cili thérret në ekzistencë atë që nuk ekziston. Ne njéherë nuk ishim, por Zoti na thirri ne në ekzistencë, na béri pér veten e Tij, dhe na modeloi në imazhin e Perëndisë: "Sepse unë jam Zoti, Perëndia juaj; shenjtërohuni pra, dhe jini tē shenjtë, sepse unë jam i shenjtë," (Levitiku 11:44).

Dëshira jonë pér tē qenë njerëz tē Shenjtërisë i ka rrënjet në shenjtërinë e Perëndisë i referohet Hynisë së Tij, Qënies së tij krejt tē papërsëritshme. Nuk ka asnje si Ai në madhështi dhe lavdi. Përgjiga e përshtatshme njerëzore në praninë e një Qënieje tē tillë kaq tē lavdishme eshtë adhurimi i Perëndisë si Perëndi. Shenjtëria e Perëndisë eshtë e shprehur në veprat e Tij tē hirshme e shpenguese. Takimi me Perëndinë i cili e shfaq dhe e jep veten e bën tē mundur adhurimin, dhe adhurimi bëhet rruga primare e njoħjes së Tij. Ne adhurojmë Perëndinë e shenjtë e shpengues duke dashur çfarë Ai do.

Adhurimi ynë ndaj Perëndisë së hirshëm dhe madhështor shprehet në shumë forma. Shpesh eshtë lavdërimi dhe lutje me komunitetin e besimit. Ai gjithashtu

e shpreh veten ë vet në veprime private përkushtimi, falënderime, lavdërimë dhe bindje. Të ndarët ungjillëzues të besimit, dhëmbshuria ndaj të afërmit, të punuarit për drejtësinë dhe pastërtia morale janë të gjitha akte adhurimi para Perëndisë tonë me shenjtëri verbuese. Edhe detyrat më të thjeshta të jetës bëhen akte adhurimi dhe marrin një domethënë sakramenti, saqë adhurimi i një Perëndie të shenjtë bëhet mënyrë e të jetuarut tonë.

Jezus Krishti na zbuloi të vetmin Perëndi të shenjtë dhe modeloi një mënyrë jetese të shenjtë adhuruese për ne. Jezusi formon kuptimin tonë mbi shenjtërinë përmes jetës, flijimit, dhe mësimeve të Tij ashtu siç jepen në Ungjittë, veçanërisht në Predikimin në Mal. Si njerëz të shenjtërise ne kërkojmë të jemi si Jezusi në çdo qëndrim dhe veprim. Me anë të hirit të Tij Perëndia i bën të aftë besimtarët që adhurojnë Atë me gjithë zemrën e tyre të jetojnë si Krishti. Këtë ne e kuptojmë si esencën e shenjtërise.

Perëndia gjithashtu na ka dhënë ne dhuratën dhe përgjegjësinë e zgjedhjes. Pikërisht sepse ne jemi lindur me një natyrë mëkatare, ne jemi të prirur të zgjedhim rrugën tonë në vend të assaj të Perëndisë. (Isaia 53:6) Duke korruptuar krijesën e Perëndisë me mëkatin tonë, ne jemi të vdekur në shkelje dhe në mëkate. (Efesianëve 2:1). Në qoftë se ne do të jetojmë përsëri shpirtërisht, Perëndia, i cili thërrret në ekzistencë atë që nuk ekziston, duhet të na rikrijojë ne përmes veprës shpunguese të Birit të Tij.

Ne besojmë se Perëndia në mënyrë unike hyri në botën tonë përmes mishërimit të Birit të Tij të vetëm, Jezusit nga Nazareti, njeriut-Perëndi. Jezusi erdhi për të rikrijuar imazhin e Perëndisë në ne, duke na aftësuar të bëhemë njerëz të shenjtë. Ne besojmë se shenjtëria në jetën e besimtarit është rezultat si i një eksperience momentale ashtu edhe i një procesi të gjatë jetësor. Pas ripërtëritjes, Shpirti i Zotit tonë na udhëheq me anë të hirit tek përkushtimi i plotë i jetës tonë tek Ai. Më tej, në aktin hynor të shenjtërimit të plotë, gjithashtu të quajtur edhe pagëzimi me Shpirtin e Shenjtë, Ai na pastron ne nga mëkati original dhe banon në ne me praninë e Tij të

shenjtë. Ai na përsos në dashuri, na bën të aftë të jetojmë një jetë me pastërti morale, dhe na jep fuqi për të shërbyer!

Shpirti i Jezusit punon brenda nesh për të riprodhuar në ne karakterin e Tij prej dashurie të përsosur. Ai na bën të aftë që “të vishemi me njeriun e ri, të krijuar sipas Perëndisë në drejtësinë dhe shenjtërinë e së vërtetës” (Efesianëve 4:24). Të jesh si Perëndia është të jesh si Jezusi. Duke pasur imazhin e Perëndisë hynore të ndrequr në ne, në aktin e shenjtërimit të plotë të realizuar nga Perëndia, ne e dimë se nuk kemi arritur aty shpirtërisht akoma, qëllimi ynë jetësor është për të qenë si Krishti në çdo fjalë, mendim, dhe vepër. Duke vazduar të dorëzohemi dhe bindemi Perëndise, dhe të besojmë Perëndinë, ne “transformohemi në të njëjtin shëmbëllim nga lavdia në lavdi, posaçë prej Frymës së Zotit” (2 Korintasve 3:18). Ne marrim pjesë më tej në këtë proces kur ne jetojmë një jetë adhurimi të shprehur në shumë mënyra, duke përfshirë këtu përqafimin e disiplinave shpirtërore dhe miqësinë e përgjegjësinë e kishës lokale. Si Trup i Besimtarëve në një kongregacion specifik ne përpinqemi të jemi një komunitet i ngjashëm me Krishtin, duke adhuruar Perëndinë me gjithë zemrën tonë dhe duke marrë dhuratën e Tij të dashurisë, pastërtisë, forcës, dhe mëshirës.

Si njerëz të shenjtërisë ne nuk ekzistojmë në një boshillëk historik dhe kishtar. Ne identifiko hemi me Dhjatën e Re dhe me Kishën e Hershme. Ato që ne besojmë qartësisht na radhisin ne në traditën e Kristianizmit klasik. Ne identifiko hemi me traditën Arminiane të hirit të dhënë falas (Jezui vdiq për të gjithë) dhe lirinë njerëzore - aftësinë e dhënë të gjithëve nga Perëndia për të zgjedhur Perëndinë dhe shpëtimin. Ne gjithashtu kemi gjurmët e trashëgimisë tonë kishtare që nga Rizgjimi Wesleyan i shek XVIII dhe tek Levizja për Shenjtëri e shekujve XIX dhe XX.

Përmes shekujve njerëzit e shenjtërisë kanë pasur një “fiksim madhështor” përreth Jezusit. Ne adhurojmë Jezusin! Ne duam Jezusin! Ne mendojmë Jezusin! Ne flasim për Jezusin! Ne jetojmë për Jezusin! Kjo është esenca dhe plotësia e shenjtërisë për ne. Kjo është ajo që i karakterizon njerëzit e shenjtërisë.

3. Në jemi njerëz me mision

3a. Misioni ynë është adhurimi.

Misioni i Kishës në botë fillon me adhurimin. Pikërisht kur ne mblidhemi së bashku përpara Perëndisë në adhurim – duke kënduar dhe dëgjuar leximin publik të Biblës, duke dhënë të dhjetat dhe ofertat tona, duke u lutur, duke dëgjuar predikimin e Fjalës, duke pagëzuar, dhe duke ndarë Darkën e Zotit – ne kuptojmë më qartë qfarë do të thotë të jemi njerëzit e Perëndisë. Besimi ynë që puna e Perëndisë në botë mbushet se pari përmes kongregacioneve adhuruese na drejton ne të kuptojmë se misioni ynë përfshin marrjen e anëtarëve të rinj në shoqërinë e kishës, si dhe organizimin e kongregacioneve të reja adhuruese.

Adhurimi është shprehja më e lartë e dashurisë tonë për Perëndinë. Është adhurimi që vë në qendër Perëndinë duke nderuar Të Vetmin, i cili me mëshirë dhe me hir na shpengon ne. Konteksti primar për adhurimin është kisha lokale, ku njerëzit e Perëndisë mblidhen, jo në një eksperiencë vet-qendërizimi ose vet-lavdërimi, por në një eksperiencë vet-dorëzimi dhe vet-ofrimi. Adhurimi është kisha duke shërbyer Perëndinë me dashurinë dhe bindjen.

Adhurimi është privilegji dhe përgjegjësia e parë e njerëzve të Perëndisë. Është mbledhje e komunitetit të besëlidhjes para Perëndisë, në shpalljen dhe në përgjigjen celebriuese ndaj asaj, që Ai është, asaj që Ai ka bërë, dhe asaj që Ai prenton se do të bëjë.

Kisha lokale në adhurim është në palcë të identitetit tonë. Kisha e Nazarenasit në mënyrë esenciale është kongregacione lokal adhurues, dhe pikërisht përmes dhe në kishën lokale misioni ynë përbushet. Misioni i kishës gjen kuptimin dhe drejtimin e tij në adhurim. Në predikimin e Fjalës, celebrimin e sakramentave, leximin publik të Shkrimeve, këndimin e himnave dhe këngëve, në

lutjen e përbashkët dhe në paraqitjen e të dhjetave e ofertave tonë, ne kuuptojmë më qartë çfarë do të thotë të jemi njerëzit e Perëndisë. Në adhurim ne kuuptojmë më qartë çfarë do të thotë të bashkëpunojmë me Perëndinë në veprën e shpengimit.

Misioni ynë i adhurimit është themelor për kishën tonë. Për shkak se Kisha e Nazarenasit është në esencë kongregacione lokale adhuruese, misioni ynë i adhurimit do të përfshijë një përkushtim të vazhdueshëm ndaj fillimit të kongpcionave të reja.

3b. Misioni ynë i dhëmbshurisë dhe ungjillëzimit.

Si njerëz të përkushtuar ndaj Perëndisë ne ndajmë dashurinë e Tij për të humburin dhe dhëmbshurinë e Tij për të varférin e zemérthyerin. Urdhërimi i Madh dhe Detyra e Madhe na shtyn ne të angazhojmë botën në ungjillëzim, dhëmbshuri dhe drejtësi. Kështu ne jemi përkushtuar për të thirrur njerëzit të kthehen në besim, për t'u kujdesur për ata në nevojë, për të qëndruar kundrejt padrejtësisë dhe me të shtypurin, për të punuar në mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurive të krijimit të Perëndisë, dhe për të përfshirë në shoqërinë tonë të gjithë ata që thërrasin emrin e Zotit.

Përmes misionit të saj në botë kisha demonstron dashurinë e Perëndisë. Historia e Biblës është historia e Perëndisë që pajton botën me veten e vet, përmes Jezus Krishtit (2 Korintasve 5:16-21). Kisha është dërguar në botë për të bashkëpunuar me Perëndinë në shërbesën e dashurisë dhe të pajtimit përmes ungjillëzimit, dhëmbshurisë dhe drejtësisë.

Të dy si Urdhërimi i Madh (Mateu 22:37-39) ashtu edhe Detyra e Madhe (Mateu 28:19-20) janë themelore në të kuptuarit e misionit tonë. Ato janë dy shprehje të një misioni të vetëm, dy dimensione të të njëjtit mesazh të ungjillit. Jezusi i cili na mëson ne, "duaje Zotin Perëndinë

tënd me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde . . . dhe të afërmin porsi vetveten," (Mateu 22:37-39), është Ai që gjithashtu na thotë, "Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë, duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që unë ju kam urdhëruar" (Mateu 28:19-20).

Misioni i kishës në botë shtrihet në gjithë njerëzimin, meqë të gjithë njerëzit, duke qenë të krijuar në imazhin e Perëndisë kanë vlerë në sytë të Perëndisë. Është misioni ynë të duam dhe të vlerësojmë njerëzit ashtu siç janë dashur dhe vlerësuar nga Perëndia., i cili kërkon t'u sjellë atyre paqe, drejtësi dhe shpëtim nga mëkatë përmes Krishtit. Është misioni ynë të tregojmë dhëmbshuri e të kujdesemi ndaj atyre në nevojë. Është misioni ynë t'i kundërvihemi sistemeve sociale dhe politikave që zhvlerësojnë ose dobësojnë njerëzit.

Misioni i kishës shtrihet në tërë personin. Perëndia na ka krijuar ne si persona të plotë dhe është misioni ynë të jemi shërbyes të dashurisë së Perëndisë ndaj njerëzve, si persona të tërë - trup, frymë, dhe shpirt. Misioni ynë i ungjillëzimit, dhembshurisë dhe drejtësisë është një mision i vetëm i integruar, duke përfshirë njerëzit në nevojat e tyre fizike, emocionale dhe shpirtërore.

Misioni i kishës në botë shtrihet mbi tërë njerëzimin sepse Jezus Krishti ka ardhur në botë të shpëtojë të gjithë ata që thërrasin emrin e Tij. Si njerëz të Perëndisë është privilegji dhe përgjegjësia jonë të ndajmë lajmin e mirë të ungjillit me të gjithë ata që do të dëgjojnë. Në shërbesa publike apo në dëshmitë personale, *pasioni ynë është që të shfrytëzojmë çdo mundësi për të ftuar njerëzit në besim në Jezus Krishtin.*

Misioni i kishës në botë shtrihet mbi të gjithë njerëzit sepse Shpirti i Shenjtë në Pentakost u derdh mbi të gjithë njerëzimin (Veprat 2). Është misioni ynë t'i prezantojmë ungjillin e shpëtimit përmes Jezus Krishtit çdo personi në botë. Ne marrim fuqi nga Shpirti për të shkuar në të

gjithë botën duke shpallur Mbretërinë dhe duke marrë pjesë me Perëndinë në ndërtimin e Kishës.

Ne me një shpirt shprese dhe optimizmi zhvillojmë në botë misionin tonë të dhënë nga Perëndia. Është më tepër se sa thjesht një çeshtje apo përpjekje njerëzore. Misioni ynë është një përgjigje ndaj thirrjes së Perëndisë. Është pjesëmarrja jonë së bashku me Perëndinë në misionin e pajtimit të Mbretërisë. Është dëshmia besnike e kishës për dashurinë e Perëndisë dhe shprehja e dashurisë së Perëndisë në botë - në ungjillëzim, dhembshuri, dhe drejtësi. Është besimi ynë në aftësinë e hirit të Perëndisë për të transformuar jetët e njerëzve të thyera nga mëkatit dhe t'i përtërijë ata në imazhin e Tij.

3c. Misioni ynë i dishepullizimit

Ne jemi përkushtuar të jemi dhe të ftojmë të tjerëve të bëhen dishepuj të Jezusit. Me këtë gjë në mendje, ne jemi përkushtuar sigurimit të mjeteve (Shkolla e të Dielës, studimet biblike, grupet e vogla, etj.), përmes të cilave mund të inkurajohen besimtarët të rriten në të kuptuarit e tyre të besimit të krishtere dhe në marrëdhëniet e tyre me njeri-tjetrin dhe me Perëndinë. Ne e kuptojmë dishepullizimin si diçka që përfshin nënshtimin e vetes tonë në bindje ndaj Perëndisë dhe disiplinave të besimit. Ne besojmë se duhet të ndihmojmë njeri-tjetrin për të jetuar një jetë të shenjtë përmes mbështetjes reciproke, miqësisë krishtere dhe përgjegjësia dashuruese. Wesley ka thënë, "Perëndia na ka dhënë tek njeri tjetri për të forcuar duart e njeri-tjetrit."

Dishepullizimi i Krishterë është një mënyrë të jetuari. Është procesi i të mësuarit se si Perëndia do të donte që ne të jetonim në këtë botë. Ndërsa ne mësojmë që të jetojmë në bindje ndaj Fjalës së Perëndisë, në nënshtrim ndaj disiplinave të besimit dhe në përgjegjësi ndaj njeri-tjetrit, ne fillojmë të kuptojmë gëzimin e vërtetë të jetës së disiplinuar dhe kuptimin e krishterë të lirisë.

Dishepullizimi nuk është një përpjekje njerëzore për t'ju

nënshtuar rregullave dhe rregulloreve. Ai është mjeti përmes të cilit Shpirti i Shenjtë na çon ne në pjekuri në Krishtin. Pikërisht përmes dishepullizimit ne bëhem i njerëz me karakter të Krishter. Qëllimi përfundimtar i dishepullizimit është të transformohemi në ngashmëri me Jezus Krishtin (2 Korintasve 3:18).

Duke studiuar dhe duke medituar mbi Shkrimet, të Krishteret zbulojnë burime të freskëta në cdo lugine të tje në udhëtimin e tyre dishepullizues. Të fuqizuar nga larja me Fjalën, të përpunuar nga zhytja në Fjalën, duke pirë thellësisht të vërtetat e Fjalës, dishepujt zbulojnë për habinë e tyre se ata janë, "transformuar me anë të ripërtëritjes së mendjes së tyre" (Romakëve 12:2). Jeta e Krishterë shtrihet përpara tyre si një rrugë e lartë dhe e hapur. Me anë të fuqisë së Perëndisë ata ecin përpara në një mënyrë jetese që eklipson vlerat e thjeshta njerëzore dhe kulturale. Të freskuar prej burimeve të Fjalës, dishepujt dorëzojnë jetët e tyre në shërbesë.

Ne afirmojmë vlera jetë-dhënëse të disiplinave shpirtërore klasike në trajnimin e burrave e të grave si dishepujt të Krishtit. Disiplinat e lutjes dhe të agjërimit, të adhurimit, të studimit, të qëndruarit vetëm, të shërbimit, e të thjeshtësisë janë në të njëjtën kohë shprehje natyrale dhe përkushtimi me qëllim në jetën e besimtarit.

Dishepullizimi kërkon mbështetje reciproke dhe përgjegjësi dashuruese. Duke qenë vetëm, shumë pak nga ne do të zhvillonin disiplinat shpirtërore që të na çojnë në pjekurinë e krishtere. Ne besojmë se jemi që të inkurajojmë mbështetjen reciproke, të siguruar përmes mjeteve të tillë si klasat e Shkollës të së Dielës, grupet dishepullizuese, grupet e studimet biblik, takimet e lutjes, grupet e përgjegjësisë dhe këshillimi Krishtere, si i nevojshëm për formimin dhe pjekurinë tonë shpirtërore. Duke njojur vlerën e rolit e përgjegjësisë në klasat Wesleyane, na inkurajon të mbështesim vendin e klasave të tillë brenda kongregacionit bashkëkohor të Krishterë.

3d. Misioni ynë i Arsimimit të Lartë Krishter.

Ne jemi përkushtuar Arsimimit të Lartë Krishter, përmes të cilat, gra dhe burra, pajisen për jetën e shërbimit të Krishter. Në Seminaret tona, Kolegjet biblike, Kolegjet dhe Universitetet ne i jemi përkushtuar punës së njohurisë, zhvillimit të karakterit të Krishter dhe pajisjes së udhëheqësve në përbushjen e thirrjes tonë të dhënë nga Perëndia për të shërbyer në kishë dhe në botë.

Arsimimi i Lartë Krishter është një pjesë qendrore e misionit të Kishës së Nazarenasit. Në vitet e para të Kishës së Nazarenasit, institucionet e Arsimimit të Lartë Krishter u organizuan, për qëllimin e përgatitjes së burrave dhe grave të Perëndisë për udhëheqje dhe shërbim Krishter, në përhapjen globale të rizgjimit të Shenjtërisë Wesleyane. Përkushtimi ynë i vazhdueshëm ndaj Arsimimit të Lartë Krishter, përmes viteve, ka prodhuar një rrjet të gjërë seminaresh, Shkollash biblike, kolegjesh dhe universitetesh në të gjithë botën.

Misioni ynë i Arsimimit të lartë Krishter rrjedh direkt nga ajo se çfarë do të thotë të jemi njerëzit e Perëndisë. Ne duhet të duam Perëndinë me gjithë, "Zemrën, shpirtin dhe mendjen tonë". Prandaj ne duhet të jemi administratorë të mirë në zhvillimin e mendjeve tona, burimet tona akademike dhe në aplikimin e njohurivë tona. Në drithën e kësaj ne i përkushtohemi punës së marrjes së njohurive dhe të vërtetës së bashku me integritetin e besimit tonë. Arsimimi Lartë Krishter është një arenë e mirë për zhvillimin e administrimit të mendjeve tona. Qëllimi ynë është të jemi një arenë e karakterizuar nga diskutimi dhe zbulimi i të vërtetës dhe njohurisë mbi Perëndinë dhe mbi gjithë krijimin e Tij.

Në Arsimimin e Lartë Krishter, besimi nuk është i ndarë por i integruar për mrekulli me njohuritë, duke zhvilluar së bashku besimin dhe të mësuarit. I téré

personi ushtrohet në çdo pjesë fë mendimit e të jetës, të kuptuar në marrëdhënie me dëshirën dhe planin e Perëndisë. Karakteri i Krishtere dhe përgatitja e udhëheqësve të Krishterë, për shërbesë në kishë dhe në botë, janë përpunuar në kontekstin e të mësuarit rreth Perëndisë, njerëzimit dhe botës. Përkushtimi ndaj Arsimimit të Lartë Krishter, në formimin e tërësisë së personit, është kritik në formimin e burrave dhe grave të Krishtere, për udhëheqje misionare në kishë dhe në botë.

Si njerëz të shpenguar të thirrur për të qenë të ngjashëm me Krishtin dhe të dërguar si agentë të dashurisë së Perëndisë në botë, ne bashkëpunojmë me Perëndinë në punën e shpengimit të njerëzimit. Arsimimi i Lartë Krishter kontribuon në mënyrë domethënëse në qenien tonë si njerëz me mision – duke ofruar një gamë të gjerë njojurish – dhe është i nevojshëm për një shërbesë efektive ndaj Perëndisë në profesionet tona të ndryshme. Pjesëmarrja jonë besnike në punën shpenguuese të Perëndisë kërkon që ne të përgatisim burra dhe gra të Perëndisë, të cilët mund të zenë vendin e tyre si udhëheqës-shërbyes Krishter në kishë dhe në botë.

Bota, ku ne jemi thirrur të shërbejmë, po bëhet gjithnjë e më e lidhur mes vetes për shkak të zhvillimit teknik e shkencor dhe, çdo ditë e më e komplikuar. Ndërsa puna shpenguuese e Perëndise marshon përpara në brezat e tashëm e të ardhshëm. Dëshmia jonë besnike që Jezus Krishti është Zot e Perëndi si dhe pjesëmarrja efektive në ndërtimin e kishës, do të vazhdojë të kërkojë një përkushtim vital ndaj Arsimimit të Lartë Krishter.

Konkluzion

Kisha e Nazarenasit lindi në fillim të shekullit XX! P.F. Bresee dhe të tjerë ishin thellësishët të bindur se Perëndia i kishte thirrur ata për qëllimin e qartë të shpalljes, në kishë dhe në botë, të Ungjillit të Jezus Krishtit, në traditën e Shenjtërisë Wesleyane. Ka tregues të pagabueshëm të pranisë së Perëndisë në këtë denominacion. Nga një levizje apo e dalë nga veza Kisha e Nazarenasit tanë i kapercen 1.3 milion anëtarë dhe shërbën në 119 vende të botës.

E ardhmja e këtij denominacioni s'ka qenë kurrë më e shkëlqyer se këtë fillim shekulli të 21^{-te}! Shumë vetë besojnë se ne jemi të thirrur jo për shekullin e 20^{-te} por për atë të 21^{-te}. Ne jemi përgatitur që të japim një kontribut më të madh në botën tonë postmoderne. Ky pohim qëndron mbi themelin e trashëgimisë tonë të Shenjtërisë Wesleyane me optimizmin e saj radikal të hirit. Ne besojmë se natyra njerëzore dhe gjithashtu shoqëria, mund të ndryshohen rrënjoshtet dhe në mënyrë të qëndrueshme nga hiri i Perëndisë. Ne kemi një konfidencë të papërmabjatshme në këtë mesazh shpresë, i cili rrjedh nga zemra e Perëndisë tonë të shenjtë.

P.F. Bresee ishte i dashruar pas shprehjes, "Dielli nuk perëndon kurrë në mëngjes." Është akoma mëngjes në Kishën e Nazarenasit, dhe dielli nuk perëndon kurrë në denominacionin tonë në mbarë botën. Ne jemi thellësishët optimist mbi ndikimin që do të kemi mbi botën tonë të shekullit të 21^{-te} me mesazhin e shenjtërisë.

Me qartësi vizioni, përkushtimi total dhe besim të palëkundur, ne shohim shekullin që po vjen si dita e mundësisë tonë më të madhe, për të bërë dishepuj të Krishtit e si Krishti nga të gjitha kombet.